



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 181 prot.

Tiranë, më 30.01 . 2023

MENDIM ME SHKRIM

Për gjykimin në seancë plenare të çështjes me:

- KËRKUES:** 28 Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/5 Deputetëve).
- SUBJEKT I INTERESUAR:** Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
- OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH i Vendimit Nr.589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 4,7,18,81,116 dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
Nenet 27,49,50 dhe 51 të Ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të R.Sh”, i ndryshuar.

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

I/E nderuar Kryetar/e i Gjykatës Kushtetuese,

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr.589 datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.

Në datën 14.10.2022, Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën objekt gjykimi.

Në vijim të shkresës Tuaj Nr. 719/2 Prot. datë 01.12.2022 “Kërkim mendimi”, (protokolluar datë 09.12.2022 në institucion), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri), paraqet mendimin e tij me shkrim në përputhje me ;

- statusin e institucionit të pavarur publik;
- të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe
- në përmbushje të qëllimit për garantimin e të drejtës së çdo personi për barazi përpara ligjit.

I. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM DHE AKTET NDËRKOMBËTARE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹

Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit.

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli Nr. 12 KEDNJ

Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit.

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo

¹ Ratifikuar me ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 FZ. 20-1996

mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1 – Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2 – Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3 – Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Neni 6 – Trajtimi i ndryshëm i përligjur

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 21 – Komisioneri

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më poshtë komisioneri, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është person juridik publik.

Neni 22 – Statusi

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32 – Kompetencat

1. Komisioneri ka kompetencë:

gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

II MENDIM ME SHKRIM

Për të trajtuar drejt pretendimin e kërkuarit në lidhje me trajtimin e diferencuar të subjekteve, duke përjashtuar nga ndjekja penale të gjithë subjektet që kanë ndërtuar pa leje për qëllime fitimi në rast të nënshkrimit të aktit noterial, kontratë premtim shitje, përmes të cilit kalojnë, sipërfaqet pa leje ose në tejkalim të saj, në favor të shtetit, në kuptim të ngritjes së kuptueshmërisë së tij në nivelin kushtetues, do parashtrojmë në mënyrë të përgjithshme duke evidentuar gjatë analizës pretendimin në lidhje me cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në referim të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa, paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”,

si dhe

“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”
(*shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde për të vlerësuar nëse një ligj apo një nen i tij, është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës. Në të tilla raste

ajo që do duhej të konsiderohej është nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

“Parimi i barazisë nuk lejon që të njëjtat t’i trajtosh ndryshe dhe të ndryshmet në thelb t’i trajtosh njësoj. Parimisht është në diskrecionin e ligjvënësit që të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasoja juridike të njëjta me qëllim që t’i rregullojë ato njësoj nga pikëpamja juridike. Por këtë zgjedhje ligjvënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme (BVerfGE 53, 313 (329)).

Fakti nëse në raste të caktuara është respektuar apo jo në thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet në lidhje me veçoritë dhe karakteristikat e çështjes konkrete që synohet të rregullohet.”

(vendimi (Beschluss) i Senatit të Dytë, datë 09.03.1994 – 2 BvL 43, 51, 63, 64, 70, 80/92, 2 BvR 2031/92).

Mbrojtja kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga KEDNJ-ja garantohet edhe nga neni 14 i saj, si parim thelbësor i shtetit të së drejtës dhe me rëndësi themelore për vlerat e tolerancës dhe paqes shoqërore. Kjo mbrojtje përforcohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji. Neni 14 i KEDNJ-së gjen zbatim edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk trajtojnë ndryshe persona që ndodhen në situata dukshëm të ndryshme (*shih Weida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.01.2013, § 87*). Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm” (*shih Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89*).

Për një kuptueshmëri më të mirë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit legjislatori ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohen e dhe format e diskriminimit, të cilat në thelb janë forma të tipizuara sjelljeje që shkaktojnë cenim të parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Gjithashtu ky ligj është përfaruar plotësisht me standartet e Bashkimit Europian, konkretisht me katër Direktiva në këtë fushë².

² Ligji është përfaruar plotësisht me:

1. 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.
2. 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
3. 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”.
4. 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimin dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo-shteruese shkaqesh³.

Në këtë kontekst përligjet kuptimi i barazisë, sipas të cilit: duhen trajtuar në mënyrë të ndryshme situata të ndryshme. Në të kundërt, nëse trajtohen në mënyrë të njëjtë situata thelbësisht të ndryshme atëherë jo vetëm që parimi i barazisë thelbësore nuk konkretizohet, por edhe parimi i barazisë formale mbetet i porealizuar.

Pikërisht nën dritën e këtyre standarteve, Komisioneri jep mendimin e tij sa i përket pretendimit për çënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Me VKM Nr.589, datë 07.09.2022 objekt i këtij gjykimi, Këshilli Ministrave ka përcaktuar miratimin e rregullave dhe procedurave për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje me qëllim fitimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar. Ky akt parashikon nga pika 6 e më tej procedurën e konfiskimit të këtyre objekteve, ndërsa në pikat 2-4 parashikon mundësinë që zhvilluesi apo çdo subjekt i autorizuar prej tij, me akt noterial të kalojë në favor të shtetit, me kontratë premtim shitjeje me vlerë 1 euro, shprehimisht ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore, të drejtën e pronës të sipërfaqeve të ndërtuara pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit, me qëllim përdorimin e tyre për nevoja të strehimit social apo për interes publik, duke i njohur së fundmi këtyre edhe një të drejtë parablerje me çmim tregu.

Për të vlerësuar nëse Akti normativ çënon barazinë përpara ligjit, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, do të duhet të konsiderohet nëse ky Akt ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se konstatohet ky fakt, do të duhet të vlerësohet nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, duhet të shqyrtojë nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Parimisht është e drejta e ligjvënësit të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasoja juridike të njëjta, me qëllim që t'i rregullojë ato juridikisht në mënyrë të njëllotë. Por këtë zgjedhje

³Në nenin 1 parashikohet shprehimisht "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

ligjvënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme. Fakti nëse në raste të caktuara është respektuar ose jo në thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet në lidhje me veçoritë dhe karakteristikat e çështjes konkrete që synohet të rregullohet (*shih vendimin nr. 60. datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*)

Konkretisht VKM Nr.589, datë 07.09.2022 objekt shqyrtimi, i referohet një kategorie të caktuar ndërtimi pa leje. Kjo do të thotë që objektet që do të preken nga efektet e këtij akti duhet të jenë ndërtuar për qëllime fitimi dhe jo për përdorim vetjak apo familjar në formën e banesës.

Pra, për këtë kategori ndërtimi, për të cilën paligjshmëria e veprimit është evidentuar nga organet përkatëse, dhe autoritetet nuk kanë vepruar konform dispozitave ligjore, akti normativ vendos miratimin e rregullave dhe procedurave për konfiskimin për një interes shumë të lartë, interesin publik.

Vetë Ligji nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nuk bën ndonjë dallim thelbësor midis zhvillimit të pronës për qëllime personale apo ekonomike, edhe pse në llojet e ndërtimeve vendos një klasifikim midis ndërtimit për banesë dhe ndërtimit për veprimtari ekonomike (Neni 1 shkronja d, Neni 4 shkronja a dhe Neni 16 shkronja ç).

Më specifik është Kodi Penal i R.Sh, i ndryshuar, i cili për efekt të dallimit të subjekteve të ndryshme në bazë të llojit të ndërtimit dhe raportit me pronësinë e truallit, në Nenin 199/a (Ndërtimi i paligjshëm)⁴ trajton efekte penale të ndryshme duke dalluar disa subjekte:

- Subjekti që ka kryer një ndërtim pa leje në tokën e tij/saj;
- Subjekti që ka kryer një ndërtim të paligjshëm për nevojë strehimi;
- Subjekti që ka kryer ndërtim të paligjshëm në tokë publike ose në tokën e një subjekti tjetër;
- Subjekti që ka kryer ndërtim të paligjshëm për qëllime fitimi.

Në këtë kuptim, në kuadër të parimit të barazisë si dhe trajtimit ndryshe të situatave të ndryshme, pavarësisht se sjellja e kryer është e njëjtë (ndërtim i paligjshëm), ekziston një dallim midis subjekteve që e kanë kryer atë sjellje dhe një nga kriteret dallues është pikërisht nëse qëllimi i ndërtimit është apo jo për përfitim ekonomik.

Nisur nga kjo, për aq kohë sa rendi juridik pranon që të ketë trajtime të diferencuara të subjekteve që kryejnë të njëjtin veprim por që ndodhen në situata të ndryshme në një juridiksion kaq të rëndësishëm siç është ai penal, në parim nuk mund të pengojë që edhe në juridiksione tjera të ketë diferencime por gjithmonë në situata të përligjura dhe objektivisht të justifikueshme e në respekt të parimit të proporcionalitetit.

⁴ Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Në lidhje me llojin e subjekteve që ndërtojnë për qëllime fitimi VKM 589/2022 bën dhe një diferencim midis subjekteve që bëjnë një marrëveshje noteriale sëbashku me organin kompetent të administrimit të pronave dhe subjektet që nuk bëjnë një marrëveshje të tillë, por i nënshtrohen procedurave të konfiskimit sipas parashikimeve të aktit normativ. Edhe pse natyra e subjekteve është e njëjtë (subjekte që kanë ndërtuar në paligjshmëri ndërtime për qëllime fitimi), është mënyra si trajtohet paligjshmëria e tyre ajo që i bën të ndryshëm. Në rastin e marrëveshjes noteriale ndërtimi i paligjshëm mund të hyjë në procedura të mëtejshme në organet kompetente dhe në disa raste mund të hyjë brenda kufijve të ligjshmërisë në rast miratimi (Shiko pika 3 e VKM 589/2022)⁵; ndërsa, në rastin e ndjekjes së procedurës së konfiskimit kjo mundësi nuk ekziston, pasi kjo procedurë vepron në kuadrin e një kundravajtje administrative dhe konfiskimi është pasojë e paligjshmërisë së konstatuar.

Gjithsesi, në të dyja rastet përfundimi është i njëjtë: kalimi i pjesevë të paligjshme në favor të Shtetit i cili i përdor për interes publik me karakter social. Në këtë kuptim është e rëndësishme të kuptohet arsyeja e diferencimit ose e krijimit të këtyre kategorive (subjekte me marrëveshje noteriale dhe subjekte pa marrëveshje), ndërkohë që përfundimi apo arritja e qëllimit është e njëjtë, si dhe nëse është e nevojshme kryerja e këtij diferencimi ndërkohë që interesi publik mund të arrihet njëllor duke ndjekur procedurën e konfiskimit të parashikuar në pikën 6 e në vazhdim të VKM 589/2022.

Përsa i përket kësaj, VKM Nr.589, datë 07.09.2022 objekt gjykimi kushtetues, në raport me veprën penale parashikuar në Nenin 199/a të Kodit Penal, është shumë e rëndësishme që të testohet dhe të kuptohet nëse efektet e sjelljes në thelb të ngjashme në njërin juridiksion, kufizojnë në mënyrë jo objektive dhe të paarsyeshme apo avantazhojnë në mënyrë joproporcionale subjektet në një juridiksion tjetër. Pra, nëse juridiksionet interferojnë me njëra tjetrën dhe nëse kanë një ndikim të atillë që të mund të ndryshojë kuptimin dhe pasojat e sjelljes nga një juridiksion në një juridiksion tjetër. Në rastin konkret, dyshimi i referohet rasteve të procedurës së ndjekur nëpërmjet marrëveshjes noteriale dhe parashikimit të ligjshmërisë së veprimit fillimisht të paligjshëm dhe nëse ky ndryshim mund të ndikojë në juridiksionin penal duke mos bërë të mundur ndjekjen penale apo vazhdimin e saj nëse ka nisur.

Në lidhje me këtë, Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmbledhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Ndërkohë, konstatojmë se VKM Nr.589, datë 07.09.2022 në tërësinë e saj është një akt me natyrë administrative dhe në asnjë rast nuk referon ekspresivisht parashikime që interferojnë apo ndikojnë në juridiksionin penal. Gjithsesi, parashikimi i një sjellje alternative për arritjen e të njëjtit qëllim i cili mund të krijojë baza për trajtim të diferencuar duhet gjithmonë të arsyetohet dhe të ketë një shpjegim të qartë mbi arsyet e këtij veprimi dhe qëllimet që synohen të arrihen.

⁵ Akti noterial i parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, përbën shprehjen e interesit të subjektit për një ndryshim të lejes së ndërtimit, e cila merret në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Nëse kërkesa pranohet, Këshilli Kombëtar i Territorit vendos ndryshimin e lejes përkatëse të ndërtimit duke njohur të drejtën e ministrisë përkatëse për administrimin e pronave shtetërore si bashkëpërfutuese e objektit të ri, i cili do të konsiderohet si objekt i ndërtuar në kushtet e lejes së ndërtimit.


Komisioneri e ka të pamundur të parashikojë efektet e zbatueshmërisë së juridiksionit administrativ dhe ndikimet e tij mbi juridiksionin penal, por në përfundim mund të japë një vlerësim si më poshtë:

Nëse qëllimi i vendosur për t'u arrirë që është ai i realizimit të interesit publik për nevoja sociale, mund të arrihet në mënyrë efektive nëpërmjet procedurës së konfiskimit dhe ndërkohë, krijimi një sjellje të re siç është ajo e marrëveshjes noteriale, mund të krijojë dyshime mbi zbatueshmërinë efektive të juridiksionit penal duke gjeneruar në thelb trajtim të diferencuar të subjekteve për të njëjtën shkelje (ndërtim i paligjshëm në kuptim të Nenit 199/a), si dhe kur kjo sjellje nuk ka një arsye objektive dhe justifikim të ligjshëm, atëherë ky parashikim mund të krijojë premisa për dyshim të arsyeshëm të shkeljes së parimit të barazisë, në kuptimin e trajtimit ndryshe të situatave të njejta.

Duke Ju falenderuar,

Me konsideratë,

KOMISIONERI



ROBERT GAJDA



